

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, sipas gjyqtarit, Halil Zahiri, duke vendosur në çështjen juridiko-civile të paditëses, KEDS, Divizioni i furnizimit, Distrikti në Gjilan, i përfaqësuar prej të autorizuarit, _____, jurist nga Gjilani, ndaj të paditurit, _____, nga Gjilani rr. _____ pa nr, për kompensimin e dëmit, në seancën kryesore dhe publike të mbajtur në mungesë të të paditurit më dt.30.03.2018, bie këtë

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesnadia e paditëses KEDS, Divizioni i furnizimit, Distrikti, në Gjilan, ndaj të paditurit, _____, nga Gjilani dhe **DETYROHET** i padituri që t ia kompensojnë paditëses dëmin e shkaktuar për hargjim të energjisë elektrike në mënyrë të paautorizuar, në shumën e të hollave në lartësi prej **149,64 €**, /nuk e ka kërkuar kamatën/ këtë në afat prej 15 ditësh, pas ditës së plotfuqishmërisë së këtijë Aktgjykimi, me vërejtje të përmbarimit të detyruar.

II. DETYROHET i padituri t ia paguajnë paditëses shumën e të hollave në lartësi prej 20 €, në emër të pagesës së taksës gjyqësore.

A r s y e t i m

Paditësja, KEDS, Divizioni i furnizimit, Distrikti, në Gjilan, me padi kishte konfirmuar se i padituri, _____, nga Gjilani, e ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike, me këtë veprim i ka shkaktuar dëmin material paditëses KEDS, Divizioni i Furnizimit, Distriktit i rjetit, në Gjilan, për shumën e të hollave në lartësi prej 149,64 €.

I autorizuari i paditëses, _____, jurist, nga Gjilani, i propozoi gjykatës ta aprovoi kërkespadinë e paditëses si të bazuar dhe të detyrohet i padituri t ia paguajnë paditëses në emër të dëmit material të shkaktuar shumën prej 149,64 €. Nuk e kërkoi kamatën dhe shpenzimet e procedurës, përveq pagesës së taksës gjyqësore, në lartësi prej 20,00 €.

I padiuri, _____, nuk ka ushtruar përgjigje në padi, ndërsa gjykata i ka dorëzuar padinë dhe aktvendimin për të ushtruar përgjigje në padi, të cilën e ka pranuar më dt.11.09.2017, i padituri është ftuar për seancat dëgjimore, të dt.04.10.2016, ftesën e ka pranuar më dt.24.06.2016, për seancën e dt.18.01.2018 ftesën e ka pranuar më dt.20.11.2017 dhe për seancën e dt.20.03.2018, ftesën e ka pranuar më dt.23.01.2018, nuk prezntoi dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, për këtë i autorizuari i paditëses propozoi gjykatës të mbahet seanca kryesore në mungesë të të paditurit dhe të lexohen-administrohen të gjitha provat nga lënda.

Gjykata ka vendosur të mbahet shqyrtimi në mungesën e të paditurit, ndërsa në bazë të nenit 8 të LPK-ës, gjykata i ka lexuar dhe administruar të gjitha provat nga lënda si vijon:

- Lexohet dhe administrohet, Aktgjykimi P.nr.487/2012, i lëshuar më dt.01.11.2012, prej Gjykatës Komunale në Gjilan. Nga kjo provë gjykata konstatoi se i padituri, _____, nga Gjilani, ishte gjykuar dhe shpallur fajtor për veprën penale vjedhje, nga neni 252 par. 1 të KPK-ës.

- Lexohet dhe administrohet, Kartela e transaksionit të konsumatorit, DGL - , në emër të / , nga Gjilani, e lëshur më dt.28.07.2017, prej KEDS, Divizioni i furnizimit, Distrikti i rjetit, në Gjilan. Nga kjo provë gjykata konstatoi se i padituri në emër të kompensimit të dëmit material për energjinë elektrike të hargjuar në mënyrë të paautorizuar, do t ia kompensoi paditëses, shumën në lartësi prej 149,64 €.

- Lexohet dhe administrohet, Kartela e transaksionit të konsumatorit, DGL - , në emër të / , nga Gjilani, e lëshur më dt.10.01.2018, prej KEDS, Divizioni i furnizimit, Distrikti i rjetit, në Gjilan. Nga kjo provë gjykata konstatoi se i padituri në emër të kompensimit të dëmit material për energjinë elektrike të hargjuar në mënyrë të paautorizuar, do t ia kompensoi paditëses, shumën në lartësi prej 149,64 €.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari paditëses deklaroi se në tërësi qëndroi pran padisë, i propozoi gjykatës që kërkespadinë e paditëses, ta aprovoi në tërësi si të bazuar dhe të detyrohet i padituri t ia paguajnë paditëses shumën e të hollave në lartësi prej 149,64 €, për kompensimin e dëmit material, nuk e kërkoi kamatën dhe shpenzimet e procedurës, përveq pagesën e taksës gjyqësore në lartësi prej 20,00 €.

Gjykata Themelore, në Gjilan pas vlerësimit të provave, në hollësi veç e veç, e ka konstatuar gjendjen faktike si vijon:

- Në bazë të provave të administruara të cekura më lart është vërtetuar gjendja faktike se i padituri nuk ia ka paguar paditëses shumën e të hollave në lartësi prej 149,64 €, në emër të kompensimin të dëmit material, për-hargjimin të pa autorizim të energjisë elektrike.

Në bazë të nenit 151 pika a, b dhe c. konfirmohet se i padituri nuk iu ka përgjigjur ftesës për seancë dëgjimore, mungesën nuk e ka arsyetuar, gjykata konsideroi se në bazë të fakteve dhe provave bashkangjitur në padi, vërtetohet se ekziston themelsia e kërkesëpadisë dhe janë plotësuar kushtet ligjore që gjykata të bie Aktgjykim për shkak të mungesës.

Nga të cekurat më lartë në bazë të nenit 151 pika a, b dhe c, të LPK-ës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Në bazë të nenit 450, të LPK-ës, sejcila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Gjyqtari
Hatil Zahiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi, mund të ushtrohet Ankesë Gjykatës së Apelit, në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njejtit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftuara përmes kësaj Gjykate.